



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 338/6 Prot.

Tiranë, më 26 . 05 . 2026

V E N D I M

Nr. 119, Datë 26 . 05 . 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 47, datë 12.02.2026, e z. R.Sh kundër Bashkisë Fier, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes shoqërore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, informon se: *“Paraqes këtë ankesë kundër Bashkisë Fier për trajtim diskriminues lidhur me aksesin në furnizimin me ujë në banesën sociale ku jetoj. Jam person i papunë dhe jetoj i vetëm në një ambient që më është dhënë nga Bashkia si strehim social, pa kontratë qiraje të formalizuara. Në zbatim të ligjit për faljen e detyrimeve, më janë zeruar të gjitha gjobat dhe detyrimet deri në vitin 2024. Për vitet 2025–2026 kam kryer pagesë për detyrimet përkatëse dhe aktualisht nuk figuroj debitor. Shoqëria e Ujësjetës-Kanalizimeve ka kryer hapjen e furnizimit me ujë. Megjithatë, nga ana e Bashkisë nuk po garantohet në praktikë ushtrimi i këtij shërbimi, duke më lënë pa akses real në ujë të pijshëm, ndonëse nuk kam detyrime të papaguara dhe më është kërkuar të lidh kontratë shërbimi si çdo qytetar tjetër.*

Në banesën sociale që më është dhënë nga Bashkia pa pagesë, kam 14 vite pa ujë të pijshëm, dhe kam kaq vite që kërkoj të drejtën time.

Vlerësoj se kjo situatë përbën trajtim të pabarabartë dhe diskriminues për shkak të gjendjes sime ekonomike dhe statusit tim si person i papunë dhe përfitues i strehimit social.

Mohimi ose pengimi i aksesit në një shërbim bazë jetik si furnizimi me ujë, në mungesë të një arsyeje ligjore objektive dhe proporcionale, përbën trajtim më pak të favorshëm krahasuar me persona të tjerë në kushte të ngjashme”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për garantimin e furnizimit me ujë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës të paraqitur nga ankuesja, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 338/1, datë 18.02.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Bashkia Fier dhe UK Fier, për ankesën e bërë.

Me shkresën nr. 574/1, datë 27.02.2026, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a, informoi Komisionerin se: “Së pari; Bazuar në shkresën nr. 593/1, datë 27.02.2026 me lëndë “Kthim përgjigje” nga Drejtoria e Shitjes pranë UK Fier, verifikohet se në emër të z. R.Sh nuk rezulton të jetë nënshkruar kontratë furnizimi, si rrjedhojë nuk figuron të jetë debitor dhe përfutues i shërbimeve që shoqëria jonë ofron.

Së dyti; Nga kontakti me Bashkinë Fier na u konfirmua se individët që përfshihen në kategorinë vulnerabël dhe përfitues të lehtësirave nga bashkitë që administrojnë vendbanimet e tyre duhet si fillim të nënshkruajnë një kontratë me këto institucione dhe më pas për lidhjen e kontratave në emër të tyre pranë shoqërisë sonë duhet ta paraqesin fizikisht atë. Ankuesi nuk është paraqitur në asnjë moment pranë zyrave tona me një kontratë të tillë.

Së treti; Bazuar në Kodin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime, neni 4.5.2, Ndërprerja e furnizimit me ujë parashikon lehtësirat që shoqëria jonë ofron kundrejt kategorive vulnerabël. (e) Konsumatori me ndihmë sociale, do të furnizohet nga ndërmarrja 20l/person në ditë, falas, si dhe shoqëria do instalojë ujëmatësin me qëllim që konsumi i ujit përtej kësaj norme të paguhet. Lista e konsumatorit të favorizuar do të merret zyrtarisht nga bashkia/komuna e zonës së shërbimit të shoqërisë.

Për sa më sipër, UK Fier nuk ndodhet në kushtet e diskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike ose shoqërore kundrejt ankuesit”.

Me shkresën nr. 2294/1, datë 09.03.2026, Bashkia Fier, informoi Komisionerin se: “Bashkia Fier si Njësi e Vetëqeverisjes Vendore, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, gëzon kompetenca ligjore dhe ushtron funksione administrativo-ligjore, pa dallime gjinie, race, feje, identiteti gjinor, bindje politike, etj.

Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Fier nr. 3, datë 31.01.2022 “Për miratimin e kërkesës së familjes/individit të pastrehë e në nevojë të z. R.Sh, për strehim në banesat sociale me qira, pronë e Bashkisë Fier, si dhe të kërkesës së familjes së znj. M.M, e strehuar në banesat sociale, për ndihmë në faljen e detyrimeve të prapambetura”, ku nga Komisioni i Strehimit, pasi është rivlerësuar dhe njëherë dokumentacioni ligjor i strehimit, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr. 301, datë 15.04.2021 “Për normat e strehimit”, në kushtet kur nuk disponoheshin banesa të lira, si dhe në kushtet kur situata ekonomike, sociale dhe kushtet e strehimit të shtetasit Z. R.Sh ishin në kushtet e emergjencës ka miratuar, (pika 1, e vendimit) kërkesën e familjes/individit të pastrehë në nevojë për strehim Z. R.Sh, për vijimin e strehimit të tij në ambientin “Njësi Shërbimi”, sip. 38.6 m² pa kundërshpërblim. Familja/individit duhet të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e furnizimit me energji elektrike dhe Ujësjetës Kanalizime Fier, duke ngarkuar në pikën 3, “ngarkohet me vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore, Zyra e Administrimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale me Qira, Bashkia Fier duke formalizuar nga ana juridike të drejtën e strehimit social të këtij shtetasi/individit në këtë ambient në kushtet e emergjencës për strehim, ku ishte strehuar provizorisht që nga muaji Dhjetor i vitit 2014.

- *Me Vendimin nr. 157, datë 15.08.2022 Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për ankesën e z. R.Sh, ka vendosur:
- Mospranimin e ankesës lidhur me pretendimin e mos strehimit të tij permanent, nëpërmjet programeve të strehimit social të Bashkisë Fier.*

- Konstatimin e mosdiskriminimit të z. R.Sh, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Fier.

Referuar parashtrimeve nga subjektet e këtij vendimi si dhe analizimit të argumenteve të shoqëruara me prova shkresore, ka rezultuar se për këtë shtetas Bashkia Fier duke e trajtuar si rast emergjent i ka krijuar kushte të favorshme për strehim, duke i ardhur në ndihmë me dhënie të këtij ambienti pa kundërshpërblim, pasi për të gjitha ambientet dhe banesat sociale të Bashkisë nga familjarët, paguhet pagesë qiraje mujore, po kështu fillimisht detyrimet e shërbimeve përsa i përket furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm janë paguar nga Bashkia Fier, kur për të dyja shërbimet kontratat janë në emër të Bashkisë Fier dhe ky shtetas kishte detyrimin ligjor të lidhjes së kontratës së huapërdorjes pa kundërshpërblim të këtij ambienti për strehim, në mënyrë që të paguante detyrimet mujore të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, pasi këto detyrime financiare nuk mund të vijonin të ishin detyrime financiare për Bashkinë Fier. Për analogji familjet e pastreha me status të veçantë (me persona me AK, një prindërore, të divorcuara), janë familje me kontrata qiraje vjetore të rregullta si dhe i përgjigjen detyrimeve ligjore financiare për konsumin nga ana e tyre të energjisë elektrike, si dhe ujë të pijshëm.

Në mënyrë të vazhdueshme nga Zyra e Menaxhimit të banesave sociale dhe ambienteve njësi sikurse është ambienti ku është strehuar z. R.Sh i është kërkuar të nënshkruajë kontratën e huapërdorjes me Bashkinë Fier, kjo për arsyet ligjore:

- të kalimit të kontratës nga njësi shërbimi në abonent familjar;*
- si dhe detyrimin e menaxhimit dhe sigurisë së këtij ambienti nga ky shtetas si dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore energji elektrike dhe ujë të pijshëm që do të konsumohej nga ky individ.*

Po kështu vlen të theksojmë faktin së këtij shtetasi i është dhënë nga Bashkia Fier, mundësi për program tjetër strehimi social sikurse është miratuar për programin social të strehimit, subvencionimi i qirasë në tregun e lirë, si një program tepër i përshtatshëm dhe që i përgjigjet nevojës së këtij shtetasi për strehim, të cilin ai e ka refuzuar.

Bashkia Fier çdo vit bën thirrje publike për programin e subvencionimit të banesave në tregun e lirë dhe ky shtetas duhet të shprehë interes pasi është program social nga i cili ky shtetas mund të përfitojë zgjidhe të strehimit të tij, pasi ambienti ku ai është strehuar ka qenë zgjidhje e nevojës së tij emergjente.

Po sikurse relatuam më sipër nga ky shtetas nuk ka bashkëpunim dhe asnjë shprehje interesi me drejtoritë përkatëse të Bashkisë Fier.

- *Praktikat e ndjekura nga Bashkia Fier, informacioni i marrë si dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Zyra e Administrimit dhe Menaxhimit të BSQ (banesave sociale me qira).*
 - Relacion, datë 26.02.2026 e Zyrës së Administrimit dhe Menaxhimit të banesave sociale me qira ku evidentohet qartë refuzimi i nënshkrimit të kontratës së huapërdorjes me*

Bashkinë, ku kërkesë ligjore është dhe dokumentacioni i rifreskuar në përputhje me kërkesat ligjore të akteve nënligjore të ligjit për strehimin social;

- Kontrata tip e huapërdorjes (pa kundër shpërblim) që duhet të nënshkruhet nga palët;*
- Me shkresën nr. 5361, datë 09.03.2026, nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Fier, është dërguar informacion mbi statusin social të z. R.Sh ku sqarohet se shtetasi Z. R.Sh, i datëlindjes 10.07.1964 ka përfituar pension invaliditeti deri në datën 30.04.2024. Duke filluar nga kjo datë e mbrapa ky shtetas nuk përfiton pension invaliditeti, për shkak se nuk ka dorëzuar dokumentacion mjekësor në përmbushje të kërkesave ligjore për ta përfituar atë;*
- Po kështu rezulton se ky shtetas nuk trajtohet me asnjë lloj pagese paaftësie apo ndihmë ekonomike nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Fier;*
- Shkresa nr. 2954, datë 05.03.2026 me lëndë “Kërkesë për informacion dhe dokumentacion” drejtuar FSHU, Rajoni Fier; Shkresa nr. 162/l, datë 05.03.2026 e FSHU, Rajoni Fier, shoqëruar me dokumentacionin mbi faturimin dhe shlyerjen e detyrimeve, gjeneruar nga sistemi online periudha Janar 2013 - Janar 2026;*
- Shkresa nr. 2955, datë 05.03.2026, me lëndë “Kërkesë për informacion dhe dokumentacion”, drejtuar UK Fier; Shkresa nr. 820/l, datë 05.03.2026, e UK Fier, Drejtoria e Shitjes me informacionin përkatës nga sistemi për kontratën në emër të Bashkisë Fier, ku në kllapa është shënuar (F.R i cili ka qenë qiramarrësi i mëparshëm i këtij ambienti), ku pasqyrohet në pasqyrën përkatëse Kontrata, Abonenti, detyrimi dhe pagesa, e cila fillon nga 26.03.2015 deri në 10.02.2026 ku rezulton me një detyrim 82.00 lekë;*

- *Masat e marra nga Bashkia Fier në lidhje me Shoqërinë UK Fier.*

Me akt verifikimin “Për cilësinë dhe funksionimin e matësit si dhe azhurnimi i të dhënave”, i mbajtur në datë 06.03.2026, nga grupi i kontrollit dhe Administratores së Banësve Sociale me qira, ku evidentohet se pasi i është bërë verifikimi i matësit, matësi ishte në rregull por kishte probleme me saraçineskën e cila ishte e prishur, dhe nga të cilët u vendos një e re dhe momentalisht linja është në rregull.

Si përfundim, theksojmë se e drejta për strehim në këtë ambient nga z. R.Sh e detyron atë të përmbushë detyrimet ligjore të nënshkrimit të kontratës së huapërdorjes nga i cili refuzohet pa asnjë shkak.

Po kështu shfaqja e interesit nga ana e tij i shërben nevojës së tij të strehimit, përfitimeve që parashikon legjislacioni në fuqi, por njëkohësisht respektimit të ligjit dhe nga institucioni ynë. Bashkia Fier mbetet e angazhuar në shfaqjen e interesit nga ky shtetas duke aplikuar me dokumentacionet përkatëse ligjore në lidhje me pretendimet për statusin e tij social dhe ekonomik për të vijuar me procedurat ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet specialistes së Zyrës Rajonale Fier, është njohur me përgjigjen e Bashkisë Fier.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga Bashkia Fier, ankuesi me shkresën datë 21.03.2026, ka kundërshtuar përgjigjen e dhënë nga Bashkia Fier duke parashtruar në mes të tjerash se: *“Për sa i përket shtëpisë ku jam, ju informoj se kam energji elektrike dhe jam shumë korrekt. Në librezë shkruhet Bashkia Fier dhe asnjëherë nuk ka ardhur në emrin e ndonjë personi, ndërsa fatura e ujit, që unë nuk e kam marrë asnjëherë, administratorja znj. Mirela e ka shkruar faturën e ujit F.Rr, ish-nënkryetar i bashkisë.*

Mua më është thënë nga një avokat se kontratat në emrin tim personal bëhen vetëm kur prona është private. Prandaj, nuk e firmos kontratën, sepse nuk kam para të blej banesë sociale, por unë po qëndroj aty si i pastrehë.

Bashkia ta harrojë se mund të shkruajë në emrin tim një të ashtuquajtur “kontratë”, jo për të më dënuar mua ligjërisht. Firmën time nuk kanë për ta marrë kurrë. Do të vazhdoj të rri pa ujë, do të blej ujë me cistema/autobot. Ato banesa mund të privatizohen vetëm me vendim të Kryeministrit, që të privatizohen me një çmim simbolik, 190.000 lekë të vjetra, siç i privatizoi ish-kryeministri në vitin 1993”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të subjektit ankues

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfituar të mira apo shërbime nga ana e Bashkisë Fier dhe më konkretisht në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm të banesës ku jeton.

Në bazë të nenit 23 *“Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”*, të ligjit Nr. 139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, të ndryshuar, përcaktohet se, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre, ndër të tjera për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a, është një shoqëri e cila është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Megjithatë, ajo është një shoqëri e cila, referuar ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, është në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Fier, Mallakastër, Patos, dhe Roskovec, të ndara sipas aksioneve të kësaj shoqërie.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që zotëron aksionet më të mëdha të shoqërisë dhe Bashkia Fier, si aksionarja e dytë më e madhe e kësaj shoqërie, e cila në bazë të nenit 23, të ligjit nr. Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, është përgjegjëse për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, të qytetarëve që jetojnë në juridiksionin e saj e ushtron këtë funksion të saj nëpërmjet personit juridik Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Nga aktet e administruara rezulton se ankuesi, z. R.Sh, nga viti 2015 është strehuar në një ambient shërbimi në pronësi të Bashkisë Fier, në kushtet e një emergjence për strehim.

Këshilli Bashkiak Fier, me Vendimin nr. 3, datë 31.01.2022, “Për miratimin e kërkesës së familjes/individit të pastrehë e në nevojë të R.Sh., për strehim në banesat sociale me qira të Bashkisë Fier, si dhe të kërkesës së familjes së znj. M.M., e strehuar në banesat sociale, për ndihmë në faljen e detyrimeve të prapambetura”, ka miratuar vijimin e strehimit të ankuesit në ambientin “Njësi Shërbimi”, me sipërfaqe 38.6 m², pa kundërshpërblim, por me detyrimin që familja/individit të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e furnizimit me energji elektrike dhe ujësjellës-kanalizime. Parashikimi i mësipërm tregon se vetë akti administrativ që ka legjitimuar vijimin e strehimit nuk e ka përjashtuar ankuesin nga detyrimet që lidhen me shërbimet utilitare, por përkundrazi ka parashikuar shprehimisht detyrimin e tij për përmbushjen e tyre.

Hapi i parë në vijim të miratimit të vendimit të sipërcituar konsiston në lidhjen e kontratës tip të huapërdorjes, pa shpërblim me Bashkinë Fier, e cila do t’i mundësonte ankuesit strehimin pa kundërshpërblim, por me detyrimin për të përballuar shpenzimet e rrjedhura nga kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë.

Sipas dokumentacionit të administruar, Bashkia Fier ka informuar se Zyra e Administrimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale me Qira i ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme ankuesit nënshkrimin e kontratës së huapërdorjes pa kundërshpërblim, pikërisht për të kaluar më pas në formalizimin e situatës si abonent familjar dhe për të individualizuar detyrimet që lidhen me konsumin e energjisë elektrike dhe ujit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Dsikriminimi me Vendimin nr. 157, datë 15.08.2022, ka vendosur konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit nga ana e Bashkisë Fier, lidhur me furnizimin me ujë të banesës. Në këtë vendim Komisioneri ka arsyetuar se: “Në kushtet kur, Bashkia Fier ka shlyer debitë e ankuesit për energji elektrike dhe ujë deri në momentin e miratimit të Vendimit nr. 3, datë

31.01.2022, të Këshillit Bashkiak Fier, KMD gjykon se tashmë ankuesi duhet të zbatojë detyrimin ligjor për lidhjen e kontratës së huapërdorjes pa shpërblim, si dhe lidhjen e kontratave të shërbimit me shoqëritë e sipërcituara”.

Rezulton se vetë ankuesi, në prapësimet e tij, ka deklaruar shprehimisht se nuk pranon ta nënshkruajë një kontratë të tillë. Ky deklaram i ankuesit provon se ekziston një element mosbashkëpunimi të vetë ankuesit me procedurën administrative të kërkuar për formalizimin e aksesit të tij në shërbimin e furnizimit me ujë.

Nga akt-verifikimi “Për cilësinë dhe funksionimin e matësit si dhe azhurnimi i të dhënave”, datë 06.03.2026, i mbajtur nga grupi i kontrollit dhe Administratores së Banesave me Qira, rezulton se matësi ishte në rregull, ndërsa problematika e konstatuar lidhej me saraçineskën, e cila ishte e prishur dhe u zëvendësua me një të re, duke u konstatuar se linja aktualisht ishte në rregull. Ky fakt është i rëndësishëm, pasi tregon se, në momentin e verifikimit administrativ, është marrë masë teknike konkrete nga Bashkia Fier për eliminimin e pengesës në furnizimin me ujë. Pra, nga provat e administruara nuk rezulton se Bashkia Fier ka mbajtur një qëndrim pasiv apo refuzues në raport me kërkesën e ankuesit për akses në ujë.

Po ashtu, nga shkresa e UK Fier rezulton se kontrata nr. 8208023, e lidhur në emër të Bashkisë Fier, nuk figuron debitor në sistem, ndërsa pagesat janë kryer ndër vite nga Bashkia Fier, madje shkresa evidenton se në periudha të caktuara (qershor 2025) ka pasur konsum uji. Kjo dobëson pretendimin se ankuesi ka qenë i përjashtuar në mënyrë absolute dhe të vazhdueshme nga çdo akses në furnizimin me ujë vetëm për shkak të statusit të tij social apo ekonomik.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, edhe pse ankuesi ndodhet pa dyshim në një situatë sociale të brishtë dhe ka pasur një marrëdhënie të paformalizuar plotësisht me Bashkinë Fier lidhur me strehimin dhe furnizimin me shërbimet bazë, nga provat e administruara nuk rezulton se Bashkia Fier e ka trajtuar atë në mënyrë më pak të favorshme se persona të tjerë në kushte të ngjashme. Ajo që rezulton, është ekzistenca e një mosmarrëveshjeje administrative dhe e një bllokimi procedural të lidhur me refuzimin e ankuesit për të nënshkruar aktin e nevojshëm të huapërdorjes.

Kodi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, i miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, pika 4.5.2, parashikon se: *“Furnizimi ndërpritet në këto raste: (a) Në rast mospagimi të detyrimeve financiare, Brenda afateve ligjore, rrjedhë nga kontrata e furnizimit me ujë; ... (e) Konsumatori me ndihmë sociale, do të furnizohet nga ndërmarrja 20l/person në ditë, falas, si dhe shoqëria do instalojë ujëmatësin me qëllim që konsumi i ujit përtej kësaj norme të paguhet. Lista e konsumatorit të favorizuar do të merret zyrtarisht nga bashkia/komuna e zonës së shërbimit të shoqërisë”.*

Sa më sipër, rezulton se nga njëra anë, Bashkia Fier ka detyrimin të kontribuojë në garantimin e aksesit në një shërbim bazë, sidomos për subjektet në nevojë. Nga ana tjetër, procedurat e furnizimit me ujë dhe të përfitimit nga skemat lehtësuese kërkojnë një marrëdhënie juridike të formalizuar. Në rastin konkret, provat tregojnë se ankuesi nuk figuron me kontratë furnizimi në emrin e tij pranë UK Fier; - Se nuk rezulton përfitues i ndihmës ekonomike nga Drejtoria e

Shërbimit Social të Bashkisë Fier; - Se pensioni i invaliditetit i ka përfunduar që prej datës 30.04.2024 për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit; - Dhe se ai vetë ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së huapërdorjes, e cila konsiderohej nga Bashkia si parakusht për formalizimin e mëtejshëm të statusit të tij si përdorues i ligjshëm i ambientit dhe si abonent familjar i shërbimeve.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se mungesa e një përfitimi efektiv të lehtësisë së parashikuar në pikën 4.5.2, shkronja “e”, të Kodit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, nuk rezulton të ketë ardhur nga një përjashtim i Bashkisë Fier për shkak të gjendjes ekonomike apo shoqërore të ankuesit, por nga mungesa e lidhjes së kontratës mes palëve, e cila është e nevojshme për aktivizimin e kësaj skeme në mënyrë të rregullt.

Në kushtet kur, Bashkia Fier ka ndërmarrë veprime konkrete në funksion të administrimit të situatës, përfshirë strehimin pa kundërshpërblim, mbulimin e detyrimeve në periudha të caktuara, kërkimin e formalizimit ligjor të marrëdhënies së strehimit dhe verifikimin teknik të linjës së ujit, Komisioneri vlerëson se ankuesi duhet të zbatojë detyrimin ligjor për lidhjen e kontratës së huapërdorjes pa shpërblim të banesës me Bashkinë Fier, dhe më pas lidhjen e kontratës së furnizimit me ujë të banesës.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Fier.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Fier, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Bashkia Fier, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin nenet 32 e 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. R.Sh, për shkak të gjendjes shoqërore dhe ekonomike, nga ana e Bashkisë Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)